



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 058/1
Prishtinë, më 22 janar 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 22 JANAR 2009**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 98 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalë u lajmërua kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, i cili në emër të grupit propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika: a) Miratimi i Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë, dhe b) Debati për zgjedhjet në Kosovë.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimet e z. Makolli.

Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se mbështet kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar AKR-së për pikën e parë, ndërsa për pikën e dytë kanë rezerva.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se mbështet kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar AKR-së për pikën e parë, ndërsa për pikën e dytë duhen bërë konsultime ndërmjet subjekteve politike.

Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështet kërkesën e kryetarit të Grupit Parlamentar AKR-së për pikën e parë, ndërsa pika e dytë duhet të shtrohet pas konsultimeve, me konsensus politik.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se propozimi për rezolutë do të duhej të ishte në rend të ditës. Me qenë se nuk është, nuk mund ta fusim sot, por në seancë të radhës. Ndërsa, sa i përket debatit për zgjedhjet, duhet të jetë çështje e diskutimit në Kuvend. Mirëpo, duhet të ketë kohë që deputetët të përgatiten, nuk është një çështje e cila mund të futet në rend të ditës sot.

Muferra Sinik, në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, tha se përkrahim propozimin e parë të z. Ibrahim Makolli, që Projekt-Rezoluta kundër krimeve të komunizmit të radhitet në seancën e sotme, kurse për propozimin e dytë nuk jemi konsultuar.

Bojan Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, tha se për pikën e parë mund të deklarohet pasi ta kenë marrë tekstin e Projekt-Deklaratës, kurse për pikën e dytë duhen bërë paraprakisht konsultime.

Kryetari njoftoi Kuvendin se është formuar edhe një grup i ri parlamentar, kryetar i të cilit është caktuar deputeti Slllobodan Petkoviç.

Slllobodan Petkoviç, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, tha se nuk pajtohet që këto propozime të shqyrtohen në seancën e sotme. Duhen bërë konsultime paraprake para se ato të shqyrtohen në seancë.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi (Komisioni i cili me vendim të Kuvendit e kishte hartuar Projekt-Rezolutën), **Bahri Hyseni**, tha se Raporti i Komisionit dhe Projekt-Rezoluta janë të gatshme për t’u shqyrtuar dhe miratuar në seancën e sotme.

Kryetari hodhi në votim propozimin e parë të kryetarit të Grupit parlamentar të AKR-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 48,
Kundër----- 31,
Abstenime----- 13.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që në rend dite të seancës së sotme të radhitet edhe pika e gjashtë – Miratimi i Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë për periudhën 1945-1999.

Kryetari hodhi në votim propozimin e dytë të kryetarit të Grupit parlamentar të AKR-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 23,
Kundër----- 64,
Abstenime----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk miratoi propozimin që në rend dite të seancës së sotme të radhitet edhe pika e shtatë – Debati për zgjedhjet në Kosovë.

Deputeti **Riza Smaka** (AKR) kërkoi sqarime pse nuk është radhitur në rend dite të kësaj seance edhe çështja e Trustit të Kursimeve Pensionale.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 11 e 12, pastaj më 15, 18 dhe 19 (dy seanca) dhjetor 2008.
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për biocide,
4. Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.
6. Miratimi i Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë për periudhën 1945-1999.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 11 e 12, pastaj më 15, 18 dhe 19 (dy seanca) dhjetor 2008.

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 11 e 12, pastaj më 15, 18 dhe 19 (dy seanca) dhjetor 2008.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Suzanë Novoberdaliu** i parashtoi pyetje Kryeministrit Hashim Thaçi lidhur me mbrojtjen e vendin turistik e kulturor të Novobërdës.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Novoberdaliu.

Deputeti **Enis Kervan** i parashtoi pyetje Ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me ndihmat sociale për personat që marrin edhe pensione në shtetet e tjera.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Kervan.

Deputeti **Armend Zemaj** i parashtoi pyetje Ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq lidhur me parandalimin dhe eliminimin e fenomenit abuziv të punës me fëmijë.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Zemaj.

Deputetja **Gjylnaze Syl**a i parashtoi pyetje Ministres së Energjisë dhe Minierave, Justina Pula, lidhur me projektin e termocentralit “Kosova C” dhe “Kosova e re”.

Ministrja Pula iu përgjigj pyetjes së deputetes Syl

Deputeti **Hajdin Abazi** parashtoi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me objektin e ri të Qendrës spitalore në Ferizaj.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Abazi.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me sigurinë në komunikacionin rrugor.

Ministri Pajaziti iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Hajdin Abazi** parashtoi pyetje për ministrin e Shëndetësisë Alush Gashi lidhur me kuadrin mjekësor për shërbimin e dializës në Ferizaj.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Abazi.

Deputetja **Gjylnaze Syl**a i parashtoi pyetje Kryeministrit Hashim Thaçi lidhur me padinë penale ndaj Serbisë për vrasjen, zhvendosjen e kufomave dhe fshehjen e krimit.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Syl

Deputetja **Myrvete Pantina** i parashtoi pyetje ministrit të Tregtisë Lutfi Zharku lidhur me veprimet e Qeverisë për mbrojtjen e produkteve sezonale vendore.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtoi pyetje Kryeministrit Hashim Thaçi lidhur me disa pikëpamje politike problematike të Departamentit për operacionet paqeruajtëse të OKB-së (DOPR).

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Teuta Hadri** parashtoi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me uljen e pagesës së kujdestarive për punëtorët shëndetësorë.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputetja **Teuta Hadri** parashtoi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me çështjen e rimbursimit të punëtorëve shëndetësorë.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadri.

Deputetja **Zylfije Hundozi** parashtroi pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur ndaljen e renovimit të Klinikës Neurologjike.

Ministri Alush Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje Kryeministrit Hashim Thaçi lidhur me rregullimin me ligj të statusit të familjeve të dëshmorëve.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Aliaj

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me ngritjen arsimore dhe profesionale të të rinjve në burgun korrektues të Lipjanit.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Aliaj.

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtroi pyetje ministres së Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me përzgjedhjen e gjyqtarëve pa u miratuar Ligji për gjykatat.

Ministrja Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputetja **Njomza Emini** i parashtroi pyetje ministrit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, lidhur me rastin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut, z Xhabir Zharku.

Ministri Ferati iu përgjigj pyetjes së deputetes Emini.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet e biocideve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Mahir Yagcilar**, në emër të Qeverisë, tha se nevoja për nxjerrjen e këtij Projektligji është se deri më tani fusha e produkteve biocide nuk është rregulluar me ligj.

Projektligji ka për qëllim të adresojë çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore lidhur me administrimin e produkteve biocide. Projektligji është i bazuar në Direktivën 98/8 të Komisionit Evropian.

Projektligji për produktet biocide mundëson përdorimin e rregullt të produkteve biocide. Me këtë janë përcaktuar kushtet e veçanta për përdoruesit e produkteve biocide, të cilat janë karakterizuar si të rrezikshme, shumë toksike, kancerogjene, mutagjene, toksike për reproduksion dhe të cilat nuk duhet të gjenden në shitje, të lejuara.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është të caktojë dhe rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdoren për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë të mbrojnë shëndetin e njeriut, të kafshëve dhe të mjedisit.

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dispozitat e ligjeve që duhet përafruar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

Struktura e Projektligjit është e radhitur në 11 kapituj, 62 nene dhe plus 21 shtojca të ndara në dy grupe.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë nga buxheti, përveç buxhetit të përcaktuar me vlerësim rregullativ dhe formular për vlerësim financiar.

Në fund, ministri Yagcilar i ftoi deputetët ta miratojnë Projektligjin, në parim.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për produktet e biocideve

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Berat Luzha**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Shpresa Murati**, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanoviq**, si dhe deputeti **Riza Smaka**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për produktet e biocideve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Rishqyrtimi i Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë

Kryetari i njoftoi deputetë se Kuvendi i Kosovës, në seancën e mbajtur më 6 nëntor 2008, ka miratuar Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, të cilin ia ka proceduar Presidentit të Republikës së Kosovës, për shpallje.

Në pajtim me nenin 84, pika 6, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti ia ka kthyer Kuvendit për rishqyrtim Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional, ka rishqyrtuar Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që para deputeteve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

Deputeti **Sadik Idriz**, në emër të komisionit funksional prezantoi raportin dhe kërkoi nga deputetët që atë ta miratojnë.

Kryetari hodhi në votim amendamentin e propozuar nga komisionit funksional, të cilin e miratoi Kuvendi.

Pastaj, kryetari hodhi në votim ligjin me amendamentin e miratuar. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----72,
Kundër-----1,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë.

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me nenin 3 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Kosovës dhe propozimin e Shoqatës së Prokurorëve Publik të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni** e arsyetoi Raportin para deputetëve të Kuvendit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhanë këta deputetë: Nait Hasani, Besa Gaxheri, Driton Tali, Ismet Beqiri, Sabri Hamiti, Sadik Idriz, Ibrahim Makolli, Riza Smaka, Bojan Stojanoviq, Enis Kervan dhe Ahmet Isufi, që janë dhënë në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e deputetit **Ismet Beqiri**, që votimi për kandidatë të procedohet veçmas për secilin. Rezultat i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër----- 5,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash vendosi që procedura e votimit të procedohet veçmas për secilin kandidat.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e z. Bedri Bahtiri për anëtar të Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----17,
Abstenime----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që z. Bedri Bahtiri të zgjedhet anëtar i Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim propozimin për zgjedhjen e z. Nazmi Mustafi për anëtar të Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----13,
Kundër-----62,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi propozimin për zgjedhjen e z. Nazmi Mustafi për anëtar të Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

6. Miratimi i Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë për periudhën 1945-1999

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që para Kuvendit të prezantojë Projektrezolutën.

Bahri Hyseni tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, të datës 17 tetor 2008, në bashkëpunim edhe me organizatat që e mbështesin punën e Kuvendit, duke marrë për bazë edhe dokumentet e vendeve fqinje dhe të vendeve , që kanë nxjerrë rezoluta për të dënuar regjimet e sistemeve totalitare komuniste, ka mbajtur disa mbledhje, në të cilat kanë marrë pjesë anëtarët e Komisionit nga të gjitha grupet parlamentare dhe me konsensus ka hartuar Projekt-Rezolutën kundër krimeve të komunizmit në Kosovë dhe Kuvendit ia ka paraqitur atë për miratim.

Në vazhdim, kryetari i Komisionit, Bahri Hyseni paraqiti tekstin e plotë të Projekt-Rezolutës.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projekt-Rezolutën kundër krimeve të komunizmit në Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për Projekt-Rezolutën dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, si dhe deputetët: **Sabri Hamiti, Shkumbin Demaliaj, Gani Geci, Adem Hajdaraj, Naser Rugova, Bajram Kosumi, Besa Gaxheri, Mark Krasniqi, Nait Hasani, Fatmir Rexhepi, Hashim Thaçi, Rasim Selmanaj, Edita Tahiri, Adem Salihaj, Driton Tali, Riza Smaka, Ismet Beqiri, Hydajet Hyseni dhe Zafir Berisha**, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari dha pauzë 15 minuta për t'u konsultuar me shefat e grupeve parlamentare.

Pas pauzës, kryetari tha se në konsultimet që ka pasur me shefat e grupeve parlamentare, ata janë të mendimit që Komisioni për Gjyqësi dhe Legjislacion dhe shefat e grupeve parlamentare ta përgatisin një tekst për të miratuar në seancat e ardhshme.

Kryetari hodhi në votim propozimin e cekur më lart. Rezultati i votimit ishte, si vijon;

Për-----54,
Kundër-----3,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion e Gjyqësi dhe kryetarët e grupeve parlamentare, që në bazë të debatit të kësaj seance, ta harmonizojnë tekstin e Projekt-Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë gjatë periudhës 1945-1999.
2. Teksti i Projekt-Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë gjatë periudhës 1945-1999 t'i paraqitet seancës plenare të radhës, për miratim

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:30.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale